



20 May 2019 15:38



### Laureta Vinca Mulliqi përmes një ekspozite prezantoi në Vjenë gruan kosovare

Në pallatin Schloss Potzneusiedl në Vjenë është mbajtur ekspozita personale e piktores kosovare Laureta Vinca Mulliqi. Përmes 20 portretëve, Vinca Mulliqi paraqiti gruan, dhimbjen dhe shpresën, si dhe kujtimet e emocionet e saja.

Kuratori i ekspozitës dhe organizatori Johann Gunther, vlerësoi



### MË TË LEXUARAT



Hashim Thaçi flet në Hagë

anweisen, dass 1 Portion davon so viel Kollagen enthält, wie 15 Dosen Botox. Dank dessen verschwinden die Falten und die Haut wird wieder Baby-glatt...

### dhe shpresën, si dhe kujtimet e emocionet e saja.

Kuratori i ekspozitës dhe organizatori Johann Gunther, vlerësoi lartë jetën dhe veprën e Vinca Mulliqi. Pasiuhtu, artisti dhe Prof. Ing. Peter Kotziczek krahasoi atë me piktorin e njohur Modigliani: "Një kontakt me Modigliani. Ashtu u ndjeva kur pashë pikturat e Laureta Vinca Mulliqi. Kjo ishte ndjenja ime spontane, Modigliani pra. Fryma e tij ishte shtrirë në veprat e ekspozuara të artistes", u shpreh ai në një fjalim të veçantë. Punën e piktores kosovare e lëvdoi edhe konsulli i ri Ing. Gerhard Eggerman i cili përveç fjalimit, kontribui duke shtruar drëkë për këtë aktivitet për të gjithë të pranishmit.

Në ekspozitë të pranishëm ishin dhjetëra persona, në mesin e të cilëve kishin ardhur bashkëdhëtarët si edhe mysafirë që kishin udhëtuar nga vendet e tjera si Gjermania e Zvicra siç ishte edhe E.Baloq: "kam bërë 400 km që të vij të shoh këtë ekspozitë. Ka shumë kosovarë aty ku jetoj unë në Gjermani, prandaj kisha shumë interesim të shoh për së afërmi edhe veprat e një piktores nga Kosova. Jam e fascinuar. Dua që të gjitha t'i kem pjesë të koleksionit tim", e cila e entuziazuar zgjodhi një pikturë për koleksionin e saj, përçjell KultPlus.

Këtë ngjarje e përcollën gazetaret dhe televizionet vjenazë, ku edhe së shpejti po përgatitet të dalë dokumentari në televizionin publik të Vjenës.

Sponsor të organizimit të kësaj ekspozite ishin: Bit media -member of see group, Ambasada e Kosovës në Vjenë dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës.

padrëgjatë në shoqëri



Lexo edhe: Musë Prehokaj, gjysmë shekulli në rrugën e artit pamor



### KARIKATURA E DITËS



Hashim Thaçi flet në Hagë

https://www.koha.net/kulture/163956/laureta-vinca-mulliqi-permes-nje-ekspozite-prezantoi-ne-vjene-gruan-kosovare/

20. Mai 2019